

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI”, VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE**

**RREGULLORE E FUNKSIONIMIT DHE E PRANIMIT TË KANDIDATËVE NË
PROGRAMIN E STUDIMIT**

**“MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM NË
LËNDËN INFORMATIKË”**

Vlorë, Maj 2019

KREU I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore e rregullores

Kjo rregullore është hartuar në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit dhe Rregullores së Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë.

Neni 2.

Objekti i rregullores

Rregullorja përcakton qëllimet e programit të studimit “Master Profesional në Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë”, mënyrën e funksionimit të këtij programi, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, të personelit akademik dhe administrativ, të studentëve; rregullat për pranimin e studentëve, për mësimdhënien, për kërkimin, për praktikën, për vlerësimin, për diplomimin.

KREU II. STATUSI, MISIONI DHE VEPRIMTARIA E PROGRAMIT TE STUDIMIT

Neni 3

Statusi i Programit

2.1. Programi i studimit “Master Profesional në Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë” është pjesë e programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti i Shkencave Teknike. Programi i studimit “Master Profesional në Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë”, është hapur në vitin akademik 2008-2009, me VKM Nr.1372, datë 10/10/2008 i titulluar si “Master i Nivelit të Parë në Mësuesi në lëndën Informatikë” me strukturë didaktike 1 vjeçare, 60 kredite. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë Master i Nivelit të Parë, MNP, në mësuesi për arsimin e mesëm në lëndën informamatikë. Me urdhër Nr. 439 datë 09/09/2011, të MASH, regjistrohet diploma e formës “Master Profesional në Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë”. Në vitin akademik 2010-2011 me vendim të MASH programi i studimit ndryshon në kohëzgjatje duke u shtrirë në tre semestra dhe në totalin e krediteve që ndryshojnë në 90 kredite. dhe kohëzgjatja normale e studimeve është 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik. Në vitin akademik 2018-2019 me vendim të MASH programi i studimit ndryshon në kohëzgjatje duke u shtrirë në 2 vite akademike – 4 semestra, dhe në totalin e krediteve që ndryshojnë në 120 kredite.

2.2. Programi i studimit “Master Profesional në Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë” realizohet në përputhje të plotë me rregulloren e brendshme të Fakultetit të Shkencave Teknike, UV dhe drejtohet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike si njësi bazë e këtij fakulteti.

Neni 4

Objektivat e programit

Programi i studimit “Master Profesional në Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë” ka për qëllim të zgjerojë njohuritë me përmbajtje pedagogjike dhe konjitive, për të përgatitur mësues të aftë në shkenca kompjuterike. Objektivat janë si më poshtë:

- Të përgatisim mësues të aftë në përdorimin e metodave dhe strategjive të reja të mësimdhënies, vlerësimit dhe të nxënës.

- Të aftësohen në hartimin dhe modifikimin e planeve të mësimdhënies, në promovimin e qëllimeve alternative dhe strategjive të nevojshme, në lidhje me rezultatet e vlerësimit.
- Aftësi në planifikimin dhe implementimin e mësimdhënies për nxënës me nevoja specifike.

Neni 5

Organet drejtuese

Autoriteti drejtues i këtij programi studimi është Përgjegjësi i Departamentit të Departamentit të Shkencave Kompjuterike.

Neni 6.

Personeli akademik

6.1. Personeli akademik përbëhet nga profesorati që zhvillon mësim në programin e studimit “Master Profesional në Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë”.

18.2. Në këtë program, si rregull, pranohen të japin mësim pedagogë që zotërojnë titullin profesor, profesor i asociuar, që zotërojnë gradën doktor ose janë në procesin e mbrojtjes së doktoratës.

KREU III. KRITERET E PRANIMIT TË KANDIDATËVE, REGJISTRIMI DHE TRANSFERIMET.

Neni 7

Kriteret e pranimit në programin e studimit

Kusht që studenti të regjistrohet në programin e studimit “Master Profesional në Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë” është të zotërojë së paku një Bachelor të fituar në universitetet shqiptare apo të huaja, të njësuar paraprakisht nga MAS.

Titujt e studimit që duhen patur parasysh për pranimin sipas preferencës.

1. Bachelor në Shkenca Kompjuterike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Shkenca Kompjuterike, Fakulteti i Shkencave Teknike Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë.
2. Bachelor të fakulteteve të tjera në degët e Shkencave Kompjuterike të shkollave publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
3. Bachelor të fakulteteve të tjera në degët e Shkencave Kompjuterike të shkollave jo publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
4. Do të pranohet të njihen të gjitha diplomat Bachelor Dega Informatikë Ekonomike të Fakultetit të Ekonomisë UT.
5. Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Matematikë, Matematikë-Fizikë, Fakulteti i Shkencave Teknike Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë.
6. Bachelor të fakulteteve të tjera në degët e Inxhinieri Elektrike, Matematikë, Matematikë-Fizikë të shkollave publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
7. Bachelor të fakulteteve të tjera në degët e Inxhinieri Elektrike, Matematikë, Matematikë-Fizikë të shkollave jo publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.

Kritere të tjera shtesë përcaktohen nga vetë departamenti përpara çdo fillimi të vitit të ri akademik. Dosjet e kandidatëve shqyrtohen nga komisionet përkatëse *ad-hoc*.

Neni 8

Regjistrimi i studentëve

Regjistrimet e studentëve në programin e studimit “Master Profesional në Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë” kryen nëpërmjet Sekretarisë Mësimore të Departamentit të Shkencave Kompjuterike në Fakultetin e Shkencave Teknike (FSHT).

Neni 9

Tarifa e regjistrimit

Tarifa e regjistrimit të kandidatëve është sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregulloreve të miratuara nga FSHT dhe UV.

Neni 10

Transferimet

Në programin e studimit “Master Profesional në Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë” kanë të drejtë të transferohen shtetas shqiptarë ose të huaj sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregullave të përcaktuara në statutin e UV, rregulloren mësimore të UV dhe rregulloren e brendshme të FSHT.

KREU IV. ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Neni 11

Titulli i diplomës

Programi i studimit “Master Profesional në Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë” përfundon me marrjen e diplomës përkatëse “Master Profesional në Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë”. Sasia e krediteve të grumbulluara nga studenti është 120 kredite. Diplomat që lëshohet në përfundim të programit të studimit shoqërohet me suplementin e diplomës.

Neni 12

Struktura e studimeve

Programi i studimit “Master Profesional në Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë” zhvillohet me kohë të plotë. Zgjat 4 semestra ose 2 vite akademike. Vitet akademike janë të ndarë në dy semestra dhe lëndët zhvillohen sipas planit mësimor përkatës. Në semestrin e katert zhvillohet gjithashtu praktika profesionale dhe provimi i diplomës ose mbrojtja e diplomës.

Neni 13

Gjuha e programit

Gjuha në të cilën zhvillohet programi i studimit “Master Profesional në Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë” është gjuha shqipe.

Neni 14

Kohëzgjatja e studimeve

Afati i studimeve për çdo cikël studimesh është i përcaktuar në ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Studenti mund të përfundojë studimet e plota, brenda afatit të rregullt të studimeve ose tej kufirit që parashikon ky afat, por duke iu nenshtruar detyrimeve që lindin nga kohezgjatja e studimeve përtej kohës normale.

Neni 15

Orari mësimor

Leksionet do të zhvillohen në përputhje me orarin mësimor të aprovuar nga Dekani i FSHT. Orari i shpallet përpara fillimit të semestrit në websitin e universitetit dhe ambientet e fakultetit. Orari është i detajuar dhe përcakton auditorin, kohën dhe ditët e zhvillimit të mësimit, pedagogët mësimdhënës. Orari mësimor ndërtohet mbi bazën e harmonizimit të elementëve të mësimit dhe të shpërndarjes racionale të ngarkesës së studentit. Kjo ngarkesë luhet nga 20–25 orë në javë. Kohëzgjatja e seancave mësimore është 60 minuta.

Neni 16

Kontrolli i dijes

Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet, me shkrim, me gojë ose i kombinuar me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor. Sipas rregullores së UV, kontrolli i dijeve në ciklin e dytë të studimeve realizohet përgjatë semestrit nëpërmjet vlerësimit vjetor dhe një provimi final gjithëpërfshirës. Për semestrin e verës dhe sezonin e riprovimeve të dimrit kontrolli i dijeve realizohet vetëm nëpërmjet një provimi final. Rregulla apo specifika të provimeve, pesha (përqindja) e secilit provim apo detyre në vlerësimin përfundimtar, literatura, temat ose pjesët e programit të lëndës për çdo provim, dita apo java e provimit, ora dhe salla e zhvillimit, referencat e konvertimit të pikëve në note etj. përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhet i ditur studentëve që ndjekin atë kurs. Pesha e vlerësimit vjetor ku përfshihen detyrat e kursit, projektet individuale, apo forma të tjera të vlerësimeve gjatë vitit, kundrejt vlerësimit të përgjithshëm, përcaktohet nga pedagogu i lëndës dhe mund të shkojë deri në 40%.

Neni 17

Ankimimi i studentëve

Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim Përgjegjësit të Departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin.

Neni 18

Përmirësimet e notës

Studenti ka të drejtë të përmirësojë notën në çdo lëndë, por jo më shumë se katër përmirësime gjatë gjithë periudhës së studimeve dhe jo më shumë se dy përmirësime në një vit akademik. Përmirësimet e notës bëhen vetëm në semestrin e verës, sezonin e riprovimeve të dimrit si dhe në datat e percaktura nga dekani i fakultetit para mbrojtjes së diplomes, kundrejt një tarife të miratuar. Është detyra e tij të regjistrohet në kurset që do të përmirësojë notën, pasi më parë ka bërë kërkesën në sekretarinë e departamentit. Studenti ka të drejtë të kërkojë përmirësimin e notës së një lënde jo më shumë se një herë.

Neni 19

Detyrimet lidhur me frekuentimin

Masa e frekuentimit të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve përcaktohet në rregulloren e UV-së, si dhe në rregulloren e brendshme të FSHT. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm deri në masën 75%. Numri i mungesave të lejuara përlllogarit për gjithë semestrin përkundrejt

numrit total të orëve për gjithë kursin dhe jo në bazë të orëve që i takojnë provimeve të pjesshme. Çdo pedagog pajiset me regjistrin përkates i cili përmban informacion mbi veprimtarinë e mësimdhënies dhe frekuentimit. Pedagogu përgjigjet drejtpërdrejt për saktësinë e informacionit mbi frekuentimin. Nëse studenti mungon gjatë zhvillimit të kursit dhe tejkalon numrin total të mungesave të lejuara për gjithë semestrin, atëherë studenti skualifikohet për shkak të mungesave, nuk futet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet mungesë (m) dhe përsërit kursin në semestrin e ardhshëm kur kursi ofrohet. Shënimi mungesë (m) do të do të pasqyrohet në procesverbalet përfundimtare nëse studenti ka plotësuar mungesat totale. Nëse studenti ka frekuentuar kursin por nuk paraqitet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet "Nuk u paraqit". Nëse studenti nuk ka detyrime frekuentimi, por nuk është paraqitur në asnjë prej provimeve të pjesshme duke përfshirë dhe provimin final, në procesverbalin përfundimtar të vlerësimit do të bëhet shënimi "NP" (Nuk u paraqit), në të kundërt do të bëhet vlerësimi me notën përkatëse. Studentët e të gjithë cikleve nuk mund të regjistrohen në këto lëndë për të ndjekur kursin si përsëritës, por kanë të drejtën të shlyejnë lëndën vetëm me provim, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

Neni 20

Praktika profesionale

Studentët kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale, në vitin e dytë (semestri i katërt). Me fillimin e vitit akademik, departamenti u komunikon studentëve kohën e kryerjes, programin, mënyrën e zhvillimit dhe shlyerjes së saj. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces.

Neni 21

Provimin e diplomimit dhe teza e diplomës

Në përfundim të programit të studimeve, për fitimin e diplomës studenti merr pjesë në provimin e diplomimit, ose parashikohet përgatitja e një teze diplome ose punimi të pavarur në rast kur mesatarja e lëndëve është mbi 8.5. Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga departamenti sipas kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore. Mbrojtja e diplomes bëhet e hapur. Procedura e mbrojtjes përfshin një paraqitje të pëmbledhjes së punimit të diplomës, pyetje dhe përgjigje. Në përfundim juria bazuar në vlerësimin e udhëhëqësit dhe punimin e studentit, bën vlerësimin me notë.

Neni 22

Komisioni i diplomimit

Komisioni i diplomimit përbëhet nga pesë pedagoge, prej të cilëve njëri është oponent, njëri kryetar dhe tre të tjerë anëtarë.

Komisioni caktohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. Për vlerësimin e temës mbahen parasysh këto kritere:

- a) Demonstrimi i një vetëdijeje profesionale në trajtimin e çështjes së zgjedhur;
- b) Përdorimi i metodologjisë shkencore dhe i instrumenteve të kërkimit;
- c) Origjinaliteti i punimit;
- d) Dobia e punimit;
- e) Cilësia e të shkruarit;
- f) Paraqitja teknike;
- g) Cilësia e prezantimit.

Neni 23

Regjistrimi i ecurisë së studentëve në sekretarinë mësimore

Rezultatet e frekuentimit, provimeve përfundimare të moduleve dhe të provimit ose mbrojtjes së diplomës regjistrohen në Sekretarinë Mësimore të Departamentit të Shkencave Kompjuterike dhe Sekretarinë Mësimore të FSHT.

Neni 24

Diploma dhe suplementi

Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomë “Master Profesional në Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë” të firmosur nga Dekani i FSHT dhe nga Rektori i UV dhe suplementin e diplomës.

Miratoi

Përgjegjëse e Departamentit të Shkencave Kompjuterike

Dr. Eljona PROKO